



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri: KSC-BC-2020-07
Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendos: Gjykatësi i vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 1 tetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i redaktuar publik i

**'Kërkesës URGJENTE për lëshimin e fletarrestimeve dhe për urdhra në lidhje me to',
parashtrimi KSC-BC-2020-07/F0009 i datës 22 shtator 2020**

me shtojcat publike 1-2

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtësit kujdestar të Nasim Haradinajt

Bastian Martens

I. HYRJJE

1. Në pajtim me nenet 35(2), 39(3) dhe 41 të Ligjit¹ dhe rregullat 48, 50, 53 dhe 55 të Rregullores,² Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') i bën kërkesë panelit të përbërë nga një gjykatës i vetëm ('gjykatësi i vetëm') që të lëshojë urgjentisht fletarrestime dhe urdhra për transferimin e z. Hysni GUCATI dhe z. Nasim HARADINAJ (së bashku 'të dyshuarit') për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë në bazë të nenit 15(2) ('Kërkesa').

2. Ekziston dyshim i bazuar se të dyshuarit kanë kryer një krim brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara.³ Në veçanti, provat tregojnë se të dyshuarit, vetëm ose në bashkëkryerje apo në marrëveshje me të tjerë, kanë kryer, nxitur, ose ndihmuar në kryerjen e krimeve të frikësimit gjatë procesit penal, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës, ose janë orvatur t'i kryejnë këto krime⁴. Këto akte janë të ndëshkueshme brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara në bazë të nenit 15(2) të Ligjit dhe neneve 387, 388 dhe 392 të Kodit Penal të Kosovës. Arrestimi i të dyshuarve është i domosdoshëm (i) për të siguruar paraqitjen e tyre në gjykim; (ii) për të siguruar që ata të mos fshehin, shkatërrojnë ose ndryshojnë provat, apo të pengojnë ecurinë e procesit penal; dhe/ose (iii) për të mos i lejuar ata të përsërisin ose të vazhdojnë të kryejnë krimin.⁵

3. Gjithashtu, duke marrë parasysh dyshimin e bazuar se të dyshuarit kanë kryer krime brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe se ata mund të kenë prova që janë të domosdoshme për hetimin e vetë të dyshuarve ose për hetimin në zyrat e tyre

¹ Ligji nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ('Ligji'). Nëse nuk përcaktohet ndryshe, kurdoherë që përmendet 'neni/nenet' është fjala për Ligjin.

² Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ('Rregullorja'). Nëse nuk përcaktohet ndryshe, kurdoherë që përmendet 'rregulla/rregullat', është fjala për Rregulloren.

³ Ligji, neni 41(6)(a).

⁴ Ligji, neni 16(3); Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kodi nr.06/L-074 (2019) ('KPK'), nenet 17, 28, 31-33, dhe 35.

⁵ Ligji, neni 41(6)(b).

ose vendin e arrestimit, ZPS-ja gjithashtu kërkon, në bazë të nenit 39(3) dhe rregullës 37, një autorizim për kontrollimin dhe sekuestrimin në lidhje me personat dhe vendndodhjet e sipërpërmendura.

4. Në pajtim me nenin 3(8)(a) të Ligjit, për arsye sigurie, ZPS-ja kërkon ndryshimin e vendit të procedurës për në Holandë në lidhje me këtë Kërkesë dhe të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.

II. PARAQITJA E FAKTEVE

5. Z. GUCATI është kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ('OVL-UÇK'). Z. HARADINAJ është nënkryetar i saj.

6. Më 7 shtator 2020, OVL-UÇK-ja mbajti një konferencë për shtyp në të cilën njoftoi se atë mëngjes kishte marrë një paketë me dokumente (e përbërë nga qindra faqe) që pretendohet se janë në lidhje me Task Forcën Hetimore Speciale ('TFHS') dhe/ose ZPS-në. OVL-UÇK-ja deklaroi se dokumentet përfshinin kopje të kërkesave të ndryshme për bashkëpunim dhe informacione për dëshmitarë. OVL-UÇK-ja u shpërndau lirisht kopje të atyre dokumenteve përfaqësuesve të mediave të pranishëm në konferencën për shtyp.⁶ Gjykatësi i vetëm autorizoi sekuestrimin e këtyre dokumenteve dhe lëshoi urdhër për ndalimin e kopjimit, regjistrimit, ose shpërndarjes së dokumenteve dhe të përmbajtjes së tyre prej cilitdo individ që i posedonte ato.⁷ ZPS-ja i sekuestroi dokumentet që kishte OVL-UÇK-ja, ku përfshiheshin dokumente të TFHS-së, disa prej të cilave të klasifikuara si konfidenciale, dhe emrat dhe të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të TFHS-së.⁸

⁶ Shtojca 1 përmban një përkthim të kësaj konference për shtyp në version të paredaktuar, së bashku me lidhjen ku mund të gjendet videoincizimi dhe audioincizimi i konferencës për shtyp në Internet.

⁷ Vendim për autorizimin e sekuestrimit, KSC-BC-2018-01/F00121, 7 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* ('Urdhri i Parë').

⁸ *Shih gjithashtu* Raport i Prokurorisë në bazë të vendimit KSC-BC-2018-01/F00121, KSC-BC-2018-01/F00124, 21 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

7. Më 16 shtator 2020, OVL-UÇK-ja mbajti një konferencë për shtyp në të cilën njoftoi se atë pasdite kishte marrë një paketë tjetër me dokumente që pretendohet se ka lidhje me TFHS dhe/ose ZPS. OVL-UÇK-ja deklaroi se dokumentet kishin lidhje me bashkëpunimin e TFHS-së/ZPS-së me autoritetet serbe dhe përfshinin deklarata të dëshmitarëve.⁹ OVL-UÇK-ja e informoi ZPS-në se përsëri i kishte lejuar përfaqësuesit e mediave që të merrnin kopje të dokumenteve.

8. Më 17 shtator 2020, gjykatësi i vetëm autorizoi sekuestrimin e këtyre dokumenteve dhe lëshoi urdhër për ndalimin e kopjimit, regjistrimit, ose shpërndarjes së dokumenteve dhe të përmbajtjes së tyre prej cilitdo individ që i posedonte ato.¹⁰ ZPS-ja i sekuestroi dokumentet që kishte OVL-UÇK-ja, ku përfshiheshin dokumente të TFHS-së, disa prej të cilave të klasifikuara si konfidenciale, dhe emrat dhe të dhënat personale të dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të TFHS-së. Të paktën tre prej këtyre dokumenteve ishin gjithashtu pjesë e dokumenteve të sekuestruara më 8 shtator 2020.

9. Më 22 shtator 2020, OVL-UÇK-ja mbajti një konferencë tjetër për shtyp në të cilën njoftoi se kishte marrë dokumente të tjera të ZPS-së që kishin lidhje me akuzat kundër individëve të caktuar, ndër të cilët Hashim THAÇI, Kadri VESELI, Azem SYLA, Jakup KRASNIQI, Rexhep SELIMI, dhe Xhavit HALITI.¹¹ Ndonëse të dyshuarit pretendojnë se nuk u bënë kopje, përfaqësuesve të mediave iu dha qasje në këto dokumente dhe u lejuan t'i fotografonin ato. Pasditen e 22 shtatorit 2020, ZPS-ja i sekuestroi dokumentet.¹² Kur punonjësit e ZPS-së pyetën se pse OVL-UÇK-ja nuk kishte kontaktuar ZPS-së përpara se të shpërndante dokumentet dhe përmbajtjen e tyre, sikurse ishte kërkuar më parë nga

⁹ Shtojca 1 përmban një përkthim të kësaj konference për shtyp në version të paredaktuar, së bashku me lidhjen ku mund të gjendet videoincizimi dhe audioincizimi i konferencës për shtyp në Internet.

¹⁰ Vendim për autorizimin e sekuestrimit, KSC-BC-2018-01/F00123, 17 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe ex parte ('Urdhri i Dytë').

¹¹ Shtojca 1 përmban një përkthim të kësaj konference për shtyp në version të paredaktuar, së bashku me lidhjen ku mund të gjendet videoincizimi dhe audioincizimi i konferencës për shtyp në Internet.

¹² ZPS-ja do të kërkojë veças miratimin e gjykatësit për këtë sekuestrim, në pajtim me rregullën 38.

ZPS-ja, z. GUCATI deklaroi se ai dhe OVL-UÇK-ja nuk janë 'bashkëpunëtorë' të ZPS-së dhe rrjedhimisht informuan mediat në vend të saj.

10. Në secilën prej këtyre konferencave, të dyshuarit përfaqësonin OVL-UÇK-në. Gjatë konferencave për shtyp, të dyshuarit identifikuan persona konkretë që kishin bashkëpunuar me TFHS-në, ose që i kishin ndihmuar ose ishin intervistuar prej TFHS-së, dhe thanë se ku banonin ata,¹³ [REDAKTUAR].¹⁴ Gjithashtu, të dyshuarit treguan mospërfillje ndaj rrezikut që përbëjnë veprimet e tyre për dëshmitarët (e mundshëm), theksuan në mënyrë të përsëritur se janë kundër dhe nuk i njohin DHSK-në dhe ZPS-në, të cilat i cilësuan si raciste dhe me motive politike, ndërsa dëshmitarët (potencialë) i quajtën 'antikombëtarë dhe njerëz që nuk e duan Kosovën'. Ndonëse herë pas here të dyshuarit kanë thënë se emrat dhe të dhënat personale të dëshmitarëve nuk duhet të bëhen publike, fryma e përgjithshme e komunikimeve dhe veprimeve të tyre tregon se ata kishin të tjera synime. Të dyshuarit kanë deklaruar se do të vazhdojnë të shpërndajnë dokumente që lidhen me hetimet e TFHS-së/ZPS-së dhe dëshmitarët (e mundshëm) dhe kanë pretenduar se priten dokumente të tjera, në format CD¹⁵.

III. FLETARRESTIMET

11. Kushtet e nenit 41(6) për arrestimin dhe paraburgimin e të dyshuarve janë përmbushur. Ekziston dyshim i bazuar¹⁶ se të dyshuarit kryen krime brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, sikurse kërkohet në nenin 41(6)(a). Gjithashtu, ndonëse përmbushja e vetëm njërit prej këtyre kushteve është e mjaftueshme si bazë për lëshimin e fletarrestimit, të dyshuarit duhet të mbahen në paraburgim në bazë të tre kushteve të përcaktuara në nenin 41(6)(b) ('kushtet e nenit 41(6)'). Ka 'arsye të artikulueshme për të besuar' se: (1) ekziston rreziku i arratisjes; (2) të dyshuarit mund të pengojnë ecurinë e

¹³ *Shih* shtojca 1, f.2-3.

¹⁴ *Shih*, shtojca 1, [REDAKTUAR].

¹⁵ *Shih*, për shembull, shtojca 1, f.14, 20; shtojca 2, f.8.

¹⁶ Kosovë, Kodi nr.04/L-123, i Procedurës Penale, 2012, neni 19(1.9). *Shih gjithashtu* [REDAKTUAR].

procedimit penal, ndër të tjera duke ndikuar tek dëshmitarët, viktimat ose bashkëfajtorët; dhe (3) shkalla e rëndësisë së krimit ose mënyra apo rrethanat në të cilat u krye ai, si dhe karakteristikat personale të të dyshuarve, sjellja e tyre në të kaluarën, mjedisi dhe kushtet në të cilat jetojnë, ose rrethana të tjera personale, tregojnë për rrezikun se ata do ta përsërisin sjelljen kriminale ose do të kryejnë një krim që kanë kërcënuar se do ta kryejnë. Konstatimi i ekzistencës së një prej këtyre tri rreziqeve lidhet me vlerësimin e mundësisë së materializimit të këtyre rreziqeve kundrejt pashmangshmërisë së tyre¹⁷.

A. DYSHIM I BAZUAR

12. Ekziston dyshim i bazuar se të dyshuarit, vetëm ose në bashkëkryerje ose në bashkëpunim me të tjerë, kanë kryer, nxitur, ose ndihmuar në kryerjen e krimeve brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, ose janë orvatur të kryejnë këto krime¹⁸.

(a) Neni 387 i KPK-së: Frikësimi gjatë procedimit penal

13. Z. GUCATI dhe z. HARADINAJ shpërndanë dokumente dhe informacion konfidencial dhe jopublik, ndër të tjera emrat, të dhënat personale, dhe hollësi të dëshmive të dëshmitarëve (të mundshëm)¹⁹. Në njoftimet përkatëse për shtyp, z. GUCATI dhe z. HARADINAJ të dyshuarit treguan mospërfillje për rrezikun që përbëjnë

¹⁷ [REDAKTUAR]; ICC/GJPN, *Prosecutor v. Bemba Gombo et al./Prokurori k. Bemba Gombos dhe të tjerëve ICC-01/05-01/13-558, Judgment on the appeal of Mr Aime Kilolo Musamba against the decision of Pre-Trial Chamber II of 14 March 2014 entitled "Decision on the 'Demande de mise en liberte provisoire de Maitre Aime Kilolo Musamba'" /Aktgjykim mbi apelin e z. Aime Kilolo Musamba kundër vendimit të Dhomës Paragjyqësore II i datës 14 mars 2014 me titull "Vendim mbi 'Kërkesën për lirim të përkohshëm të z. Aime Kilolo Musamba'", 11 korrik 2014, para.107.*

¹⁸ Ligji, neni 16(3); KPK, nenet 17, 28, 31-33, dhe 35. *Shih gjithashtu* KPK, neni 21 (1. Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale. 2. Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj. 3. Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.).

¹⁹ Përmendjet e dëshmitarëve (të mundshëm) kanë të bëjnë jo vetëm me personat e intervistuar nga ZPS-ja, por edhe me persona që ka gjasa të kenë informacion për një krim, kryesin e një krimi, ose për rrethana të rëndësishme që kanë lidhje me hetimet e ZPS-së. *Shih, në mënyrë të ngjashme*, nenin 42(1).

veprimet e tyre për dëshmitarët (e mundshëm) dhe i quajten dëshmitarët (potencialë) ‘antikombëtarë dhe njerëz që nuk e duan Kosovën’. Që të dy e theksuan publikisht se ata dhe OVL-UÇK-ja nuk i pranojnë DHSK-në dhe ZPS-në dhe se janë kundër tyre.

14. Rrjedhimisht, ekziston dyshim i bazuar se z. GUCATI dhe z. HARADINAJ e shpërndanë këtë informacion konfidencial dhe jopublik si kërcënim ose si mënyrë tjetër detyrimi për të nxitur një person ose persona të tjerë që të mos japin deklaratë, apo të japin deklaratë të rreme, ose ndryshe të mos i japin informacion të vërtetë ZPS-së dhe/ose DHSK-së.

(b) Neni 388 i KPK-së: Hakmarrja

15. Për të njëjtat arsye të paraqitura më lart, ekziston dyshim i bazuar se z. GUCATI dhe z. HARADINAJ shpërndanë këtë informacion konfidencial dhe jopublik për dëshmitarë (të mundshëm) – një veprim i dëmshëm – me synimin e hakmarrjes kundër personave që i kanë dhënë informacion TFHS-së dhe/ose ZPS-së në lidhje me kryerjen, ose kryerjen e mundshme, të një vepre penale.

(c) Neni 392 i KPK-së: Shkelja e fshehtësisë së procedurës

16. Z. GUCATI dhe z. HARADINAJ zbuluan pa autorizim dokumente dhe informacion konfidencial dhe jopublik nga procedura zyrtare, konkretisht, nga hetimet penale të TFHS-së dhe ZPS-së.²⁰ Në bazë të neneve 35(2)(f) dhe 62 dhe të rregullës 30, dhe në përputhje me Urdhrat e gjykatësit të vetëm,²¹ këto dokumente dhe informacione njihen si konfidenciale dhe jopublike në bazë të ligjit dhe/ose janë deklaruar si konfidenciale me vendim të TFHS-së ose ZPS-së.

²⁰ Nenet 6(2) dhe 15(2) përfshijnë përmes përmendjes përkufizimet e përcaktuara në nenin 384 të KPK-së, ndër të tjera që ‘procedurat zyrtare’ përfshijnë çfarëdo ‘procedurë penale’ që përkufizohet në KPPK. Neni 6 i KPPK-së, ashtu si neni 35(2)(g) i Ligjit, përcakton se prokurori fillon ‘procedurën penale’, e cila në vijim përfshin fazën hetimore.

²¹ Gjykatësi i vetëm gjykoi se dokumentet përfshinin informacione të ndjeshme, që si rregull janë jo publike. *Shih* Urdhri i Parë, KSC-BC-2018-01/F00121, para. 12; Urdhri i Dytë, KSC-BC-2018-01/F00123, para.12.

17. Rrjedhimisht, ekziston dyshim i bazuar se duke shpërndarë informacion, z. GUCATI dhe z. HARADINAJ, shkelën fshehtësinë e procedurës zyrtare.

B. RREZIKU I ARRATISJES

18. Me të mësuar për krimet për të cilat akuzohen, të dyshuarit kanë motiv të fortë që të shmangin gjykimin dhe rrezikun e vendimit të fajësisë. Të dyshuarit kanë të gjitha mjetet, motivin dhe mundësinë që t'i shmangen drejtësisë.

19. Të dyshuarit, Hysni GUCATI dhe Nasim HARADINAJ, janë përkatësisht kryetari dhe nënkryetari i OVL-UÇK-së. OVL-UÇK-ja, me 40.000 anëtarë, ka paraqitur më parë peticion për shfuqizimin e Ligjit dhe ka kundërshtuar aktivisht orvatjet e mëparshme për ndjekjen penale të ish-anëtarëve të UÇK-së për krime lufte, ndër të tjera edhe përmes protestave dhe demonstratave kërcënuese dhe mosbindjes civile. Si të tillë, të dyshuarit kanë qasje në fonde të konsiderueshme dhe lehtësisht mund të mobilizojnë një rrjet të gjerë përkrahësish, ndër të cilët ish-anëtarë të UÇK-së dhe persona me ekspertizë në lëmin e sigurisë, policisë dhe inteligjencës. Të paktën njëri prej të dyshuarve ka udhëtuar kohët e fundit jashtë shtetit.²²

20. Kosova ka vetëm një numër të vogël marrëveshesh ekstradimi me shtete të tjera, çka është me rëndësi sepse ato janë një prej mekanizmave të bashkëpunimit që përdor DHSK-ja.²³ Kjo, së bashku me numrin e vendeve që thjesht nuk e njohin Kosovën si shtet, e bën shumë të lehtë që të dyshuarit të udhëtojnë në mënyrë të ligjshme në një juridiksion që nuk do të kishte asnjë detyrim për t'i transferuar ata në DHSK. Gjithashtu, të dyshuarit sigurisht i kanë lidhjet për t'u larguar nga Kosova përmes kalimit të paligjshëm të kufirit, çka e bën të papërshtatshme zgjidhjen e dorëzimit të pasaportave prej tyre.

²² *Shih* KSC-BC-2018-01/F00124, para.2.

²³ Neni 55(2); Rregulla 208.

C. RREZIKU I PENGIMIT TË ECURISË SË PROCEDIMIT PENAL

21. Për shkak të angazhimit të tyre në OVL-UÇK, të dyshuarit kanë pozita me autoritet dhe ndikim në Kosovë. Janë në kryerje e sipër hetime aktive në lidhje me shpërndarjen e dokumenteve prej tyre. Në këto rrethana, më së paku deri sa të bëhet sigurimi i provave, paraburgimi është i domosdoshëm.

22. Rreziku që të dyshuarit të mobilizojnë përkrahësit e tyre për të penguar hetimet dhe procedimin e tyre është qartazi real, sikurse mund të shihet nga qëndrimi i tyre ndaj ZPS-së dhe DHSK-së. Të dyshuarit kanë mjetet, motivin dhe mundësinë për t'u përpjekur të pengojnë procedimin. Në veçanti, të dyshuarit kanë thënë se do të vazhdojnë të nxjerrin, pa autorizim, informacion konfidencial dhe jopublik që lidhet me hetimet dhe dëshmitarët e TFHS-së/ZPS-së, duke shpërfillur rrezikun që përbën kjo për dëshmitarët (potencialë) dhe të tjerët.

23. Duke kërkuar në mënyrë të përsëritur delegjitimimin e DHSK-së, veprimet e të dyshuarve – së bashku me pozitat e tyre me ndikim dhe tensionet brenda Kosovës – pa dyshim që do të shërbejnë si inkurajim për përpjekjet e atyre që duan të pengojnë hetimin e ZPS-së. Të dyshuarit vetë janë të aftë të provokojnë trazira publike në qoftë se e shohin se kjo është në interes të tyre.

D. RREZIKU I KRYERJES SË KRIMEVE TË MËTEJSHME

24. Sikurse u parashtrua më sipër, të dyshuarit tashmë në tri raste kanë ndërmarrë veprime që dëmtojnë dhe kërcënojnë administrimin e drejtësisë. Emrat e dëshmitarëve dhe të dëshmitarëve të mundshëm janë bërë publike dhe janë shpërndarë si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e veprimeve të tyre. Të dyshuarit kanë shprehur synimin për të vazhduar të marrin, shpërndajnë dhe bëjnë publike informacione të tilla.

25. Ekziston një rrezik i konsiderueshëm se të dyshuarit do të vazhdojnë të kërcënojnë dhe frikësojnë dëshmitarët dhe lëshimi i urdhrin për paraburgimin e tyre është i vetmi mjet për t'iu përgjigjur këtij rreziku.

E. TRANSFERIMI NË OBJEKTIN E PARABURGIMIT TË DHSK-SË

26. Në kuadër të kërkesës së ZPS-së për caktimin e vendit të zhvillimit të procedurës në shtetin pritës,²⁴ ZPS-ja kërkon që gjykatësi i vetëm të lëshojë urdher për transferimin e të dyshuarve në objektin e paraburgimit, në pajtim me rregullën 50(1)-(2).

IV. KONTROLLIMI DHE SEKUESTRIMI

27. ZPS-ja kërkon që, si pjesë e fletarrestimeve, gjykatësi i vetëm të autorizojë ZPS-në dhe/ose autoritetet zbatuese të fletarrestimit që në bashkëpunim me ZPS-në:

- a. të kontrollojnë të dyshuarit, vendarrestimin e tyre, dhe zyrën e OVL-UÇK-së; dhe
- b. të sekuestrojnë çfarëdo prove që besohet se është në lidhje me ose mund të jetë e rëndësishme për veprat penale të përshkruara më lart, përfshirë materiale që (a) pretendohet se janë të TFHS-së dhe/ose ZPS-së; dhe (b) kanë lidhje me orvatjet e kohëve të fundit për pengimin e administrimit të drejtësisë. Ndër këto mund të përfshihen kopje të dokumenteve, fotografi, videoincizime, audioincizime, si dhe kompjuterë, telefona, memorie fizike të pajisjeve për kopjim, dhe pajisje të tjera që logjikisht mund të pritët se përmbajnë prova përkatëse.

28. Ekziston dyshim i bazuar se të dyshuarit kanë kryer vepra penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe, nga ana tjetër, ekziston dyshim i bazuar se ata mund të kenë prova që janë të domosdoshme për hetimin e vetë të dyshuarve, ose

²⁴ *Shih* paragrafin 4 më sipër.

hetimet në zyrat e tyre apo në vendet e arrestimit.²⁵ Më tej, në kuadër të rrezikut të ndërhyrjes dhe pengimit, përfshirë sikurse u përshkrua më lart, çfarëdo prove që posedohet nga të dyshuarit nuk mund të sigurohet ndryshe. Kontrollimi dhe sekuestrimi në lidhje me arrestimin janë i vetmi mjet i efektshëm për realizimin e qëllimit të hetimit.²⁶

29. Cenimi që u shkaktohet të drejtave të të dyshuarve për privatësi dhe pronë është proporcional me qëllimin legjitim të hetimit dhe masa hetimore nuk eliminon thelbin e këtyre të drejtave.²⁷ ZPS-ja do ta përshtatë zbatimin e kontrollimit dhe sekuestrimit dhe/ose do t'u përcjellë informacionin dhe udhëzimet e nevojshme autoriteteve të tjera që do të ndihmojnë në zbatimin e kontrollimit dhe sekuestrimit, në një mënyrë që përjashton informacione që parashikohet të mos jenë të rëndësishme, si dhe në përputhje me garancitë e përcaktuara në rregullën 39.

30. ZPS-ja kërkon autorizim për të mbajtur çfarëdo prove të sekuestruar (i) për aq kohë sa është e nevojshme për kryerjen e shqyrtimit të provave; dhe (ii) nëse gjykohet e rëndësishme, për një periudhë të mëtejshme sikurse mund të jetë e nevojshme për hetimet dhe procedimet.

V. ZBATIMI DHE DORËZIMI I URDHRAVE

31. ZPS-ja kërkon që gjykatësi i vetëm t'ia transmetojë ZPS-së fletarrestimet dhe urdhrat për transferim, si dhe autorizimin për kontrollim dhe sekuestrim, që ZPS-ja të bëjë zbatimin dhe dorëzimin e tyre në bashkëpunim me Administratoren. ZPS-ja, në bashkëpunim me Administratoren, është autoriteti kompetent më i përshtatshëm për dorëzimin dhe/ose zbatimin e këtyre urdhrave.

32. Duke mbajtur parasysh nevojën për të vepruar në përputhje me të drejtat themelore të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, ZPS-ja do t'i zbatojë këta urdhra

²⁵ Rregulla 37(2)(a), (3). *Shih gjithashtu* nenet 35(2)(b) dhe 39(3) dhe rregullën 48(2).

²⁶ Rregullat 31(1)(b), 37(1).

²⁷ Rregulla 31(1)(c).

duke marrë masat e përshtatshme për mbrojtjen e të drejtave themelore të të dyshuarve dhe të viktimave. Çfarëdo cenimi i të drejtave në kuadër të këtyre masave do të kufizohet vetëm në çka është absolutisht e domosdoshme.²⁸ Sapo të kryhen arrestimet, të dyshuarit do të informohen për të drejtat e tyre sipas Ligjit.

33. ZPS-ja kërkon autorizim për të bërë me dije urdhrat, nëse kjo është e përshtatshme dhe e domosdoshme për zbatimin e tyre.

VI. KLASIFIKIMI

34. Ky parashtrim dhe shtojcat e tij dorëzohen për protokollim si rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* në përputhje me rregullën 85(4).

VII. MASA QË KËRKOHET

35. Për arsyet e lartpërmendura, ZPS-ja kërkon urgjentisht që gjykatësi i vetëm:
- a. të lëshojë fletarrestime për të dyshuarit dhe urdhrat gjegjës për transferim, sipas kushteve të kërkuara në pjesët III dhe V më lart; dhe
 - b. të autorizojë kontrollimin dhe sekuestrimin sipas kushteve të kërkuara në pjesët IV-V më lart.

²⁸ Për shembull, ZPS-ja mund të vendosë që në vendin ku kryhet kontrollimi dhe sekuestrimi të ndalojë përkohësisht përdorimin e komunikimeve elektronike jothelbësore. Kjo është absolutisht e domosdoshme sepse, nëse planifikohet kryerja e një numri arrestimesh dhe/ose kontrollimesh në lidhje me disa të dyshuar rreth së njëjtës kohë, të dyshuarit e tjerë mund të informohen dhe paralajmërohen se po kryhet një kontrollim, çka vë në rrezik operacionin më të gjerë. *Shih* ECtHR/GJEDNJ, *Cacuci and S.C. Virra & Cont Pad S.R.L. v. Romania*, 27153/07, 17 janar 2017, para. 65-67.

Numri i fjalëve (në origjinal): 3179

/nënshkrim/

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar

E enjte, 1 tetor 2020

Në Hagë, Holandë